

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjoba dhe pezullime në futbollin shqiptar, 6 klubeve u bllokohet merkatoja - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/gjoba-dhe-pezullime-ne-futbollin-shqiptar-6-klubeve-u-blokohe-merkatoja/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:07:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:06:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d405b2123b230603bd0634163389bdbaba7468f81f72f9afdc0831504b953533
TEKSTI	86c61ce3c02283d9093d621b5e9835a25a2b11267c56dd9da99ff56b2036c6e8
PAMJA	bf597e5fa4e03e7ed473883cec73bad910db4a46aa0be4cf95581f779f561b46

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ede91e16c218761f47725d7f771c7ede0868dde286795c312809b63764878fe2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ede91e16c218761f47725d7f771c7ede0868dde286795c312809b63764878fe2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Protesta në Tiranë Kuvendi i Shqipërisë BE Komisioni i Disiplinës dhe Etikës

LAJMI I FUNDIT | SPORT

Gjoba dhe pezullime në futbollin shqiptar, 6 klubeve u bllokohet merkatoja

17 Shtator 2026 | 18:06

Komisioni i Disiplinës dhe Etikës në Federatën Shqiptare të Futbollit ka publikuar vendimet për javën e fundit të futbollit shqiptar, ku në fokus janë gjobat për Laçin, Villazninë, Tiranën dhe Skënderbeun, si dhe pezullimet për disa zyrtarë e lojtarë.

KF Laçi është dënua me 100 000 lekë gjobë për mosmarrjen e masave të nevojshme për garantimin e rendit dhe sigurisë, si dhe për sjelljen e gabuar të spektatorëve, të cilët kanë hedhur sende në fushën e lojës, duke rrezikuar sigurinë e lojtarëve të ekipit kundërshtar.

KF Villaznia është dënua me 50 000 lekë gjobë për hedhjen e sendeve në fushën e lojës nga spektatorët. Ndërkohë, lojtari i Villaznisë, Adnard Mehmeti, është pezulluar për 2 ndeshje për provokim të spektatorëve.

Edhe Skënderbeu është dënua me 100 000 lekë gjobë, për shkak të ndezjes së flakadanëve dhe hedhjes së sendeve në fushën e lojës nga tifozët.

KF Tirana është dënua me 50 000 lekë gjobë për ndezjen e flakadanëve dhe mjeteve të tjera piroteknike nga spektatorët. Zyrtari i klubit, Omer Bunjaku, është pezulluar për 2 ndeshje për protestë ndaj vendimeve të zyrtarëve të ndeshjes.

Ndërkohë, një nga dënimet më të rënda i është dhënë zyrtarit të Vorës, Bazion Tragaj, i cili është pezulluar për 8 ndeshje për sjellje jospportive të përsëritur ndaj zyrtarëve të ndeshjes. Në zbatim të vendimit, atij i ndalohej hyrja në dhomat e zhveshjes dhe ambientet e brendshme të stadiumit deri në përfundimin e dënimit.

Komisioni ka paralajmëruar gjithashtu KF Teutën se, në rast përsëritjeje të problematikave teknike apo organizative që shkaktojnë ndërprerjen e zhvillimit normal të ndeshjes, klubi do të jetë subjekt i masave disiplinore të parashikuara në Kodin e Disiplinës dhe Etikës dhe në rregulloret e FSHF-së.

KF Oriku është dënua me 50 000 lekë gjobë për shkak të vonesës në fillimin e ndeshjes, ndërsa zyrtarët e Luzi Vogël 2008, Albert Lusha, dhe të KF Shiroka, Ardit Mani, janë pezulluar për nga 4 ndeshje për sjellje jospportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes. Zyrtari tjetër i Shirokës, Ergi Axhani, është pezulluar për 2 ndeshje për protestë ndaj vendimeve të zyrtarëve të ndeshjes.

Akademia e Futbollit U-18 është dënua me 100 000 lekë gjobë dhe humbjen në tavolinë me rezultatin 3-0 të ndeshjes ndaj Vora U-18, për mospërbushje të detyrimeve dhe përgjegjësi që shkaktuan braktisjen e takimit.

Bllokohet merkatoja për 6 klube

Komisioni i Disiplinës ka vendosur gjithashtu ndalimin e regjistrimit të lojtarëve të rinj në 3

LAJMI I FUNDIT

17:47 Kombëtarja nis përgatitjet për Nations League, Maran shpall të shtunën listën e kuqezinjve

17:43 "Arbitrazhi rrëzon kërkesat e VIA-s", MIE: Hyn në fuqi zgjidhja e kontratës për Aeroportin e Vlorës

SHPËRNDAJ Kurti pret Hamzën pas vendimit ARTIKULLINë Hagës, diskutojnë apelinin e aktgjykimit

17:26 Eurovision 2027, Irlanda do ta bojkotojë konkursin për të dytin vit

16:43 Diaspora shqiptare mblidhet në Times Square në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, prefekti i Tiranës ndan pamjet

16:22 U fut në det për t'u larë, i moshuari nga Kosova humb jetën në Velipojë

TESTIM

periudha regjistrimi për gjashtë klube, deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve të përcaktuara në vendimet e Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve.

Për KF Tiranën, masa lidhet me moszbatimin e vendimeve në çështjet e Romeo Harizajt dhe Gledi Micit.

Edhe KF Vllaznia është ndëshkuar me të njëjtën masë për moszbatimin e vendimit në çështjen e Liridon Latifit.

Bllokimi i merkatos është vendosur gjithashtu për FC Besën, për moszbatimin e vendimeve në çështjet e Emiljano Çelës dhe Bekim Kulit, si dhe për KF Lushnjën, në çështjen e Ardit Hoxhajt.

Përveç këtyre masave, KF Tirana ka marrë edhe tre afate paralajmëruese prej 30 ditësh për ekzekutimin e vendimeve në çështjet e Kleandro Lleshit, Fatmir Prengajt dhe Erisildo Smaçit.

Ndërsa KF Vllaznia ka marrë një afat paralajmërues prej 30 ditësh për ekzekutimin e vendimit në çështjen e Ildi Grudës.

Komisioni ka pranuar edhe kërkesat e lojtarëve të KF Iliria, Brajan Selmani, dhe KF Oriku, Bruno Telushi, duke pezulluar pjesën e mbetur të dënimit me kusht për një periudhë 6-mujore.

Në vendimet e tjera, Komisioni ka rrëzuar kërkesat e lojtarëve Nelson Joseph Pius të Lushnjës, Igli Rrapit të Burrelit dhe Klejdi Gjinit të Tiranës U-18.

Kundër vendimeve lejohet ankim brenda 3 ditëve pranë Komisionit të Apelit.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

LAJMI I FUNDIT | SPORT

Kombëtarja nis përgatitjet për Nations League, Maran shpall të shtunën listën e kuqezinjve

Kombëtarja shqiptare do të nisë këtë fundjavë përgatitjet për ndeshjet e UEFA Nations League, me kuqezinjtë që do të kenë një kalendar të ngjeshur gjatë...

17:47 | 17/09/2026

EKONOMI | LAJMI I FUNDIT | VENDI

“Arbitrazhi rrëzon kërkesat e VIA-s”, MIE: Hyn në fuqi zgjidhja e kontratës për Aeroportin e Vlorës

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka njoftuar se Arbitrazhi i Emergjencës ka rrëzuar kërkesat kryesore të VIA-s, koncesionarit të Aeroportit të Vlorës, dhe nuk ka...

17:43 | 17/09/2026

EURONEWS ALBANIA | KOSOVË | LAJMI KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | RAJONI

Kurti pret Hamzën pas vendimit të Hagës, diskutojnë apelimin e aktgjykimit

Një ditë pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë në Hagë ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në...

17:30 | 17/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.